

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje materiale pastrimi”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 39831200-8, 33760000-5.

Vlera e fondit limit: 2 401 250 (dymilonekatërqindnjë mijë e dyqindpesëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”* nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se *“Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit pranë autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion burimet njerëzore, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se disa nga mallrat objekt të kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave me rrezikshmëri për mjedisin, kjo deklaratë konsiderohet e rëndësishme pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Specifikimi i Materialeve: Specifikimi i Materialeve:

Nr.	Emërtimi i produktit	Specifikimet teknike
1	Acid për pastrim (liter)	Të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2	Xhel dezinfektues për duar (100ml)	Dezinfektues për duar me përmbajtje alkooli 70%. Jo irritues për lëkurën.
3	Aromatik tualeti (250ml) për aparat	Të jetë statik për tu vendosur në mur në mënyrë të pavarur. Të jetë me aromë të këndshme.
5	Cizme gome të gjata numer 42	Me material gome cilësor, të ofrojnë mbrojtje ndaj ujit. Numrat e çizmeve dhe ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
6	Cizme gome të gjata numer 43	Me material gome cilësor, të ofrojnë mbrojtje ndaj ujit. Numrat e çizmeve dhe ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
7	Doreza gome	Të jenë rezistente ndaj kimikateve të detërgjontëve dhe kimikateve të pastrimit. Të jenë për përdorim të largës së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padepërtueshme nga lëngjet.
8	Doreza Latex ose Nitrile (Masa M /L)	Josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes
9	Enë plastike të vogël me një doreze (1 Litër)	Të jetë me shënimin e shkallëzuar të mbushjes me ujë, të ketë dorezë për transportin e tij dhe të ketë një volum max 1 Litër

11	Fshesë me sfungjer dhe gome për pastimin e xhamave	Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Shkopi që përdoret për të mbajtur fshesën me sfungjer të jetë jo më i vogël se 25 cm dhe pesha e gjithë fshesës me sfungjer të jetë jo më e vogël se 216 gr.
12	Fshesë merimangash me shkop	Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim.
13	Fshesë pastrimi pa bisht	Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr
14	Fshesë pastrimi për ambjente të jashtme (industriale) me bisht	Fshesa të jetë e përberë me fije të gjata mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 26 cm +/- 2 cm marzh gabimi, gjerësi 4 cm +/- 2 cm marzh gabimi. Bishti të jetë i përbërë nga material metalik veshur me një shtesë plastike jo më i shkurtër se 25 cm
15	Furca për lyerje muri me gëlqere	Furça të jetë me bisht druri jo më e gjatë se 10 cm
16	Furca për pastrimin e ËC	Të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.
17	Gëlqere për lyerje (qese 10kg)	Të jetë llaç mbushës themelor me bazë gipsi, me përmbajtje polimerësh dhe aditivësh special për mure tulle ose blloku për ambiente të brendshme. Material në formë pluhuri me bazë gipsi, gëlqere e hidratuar, granulometri të seleksionuar rezina sintetike dhe aditive special për aplikime në ambiente të brendshme. Të jetë pa rrëshkitshmëri vertikale, me punueshmëri shumë të mirë, ngjitje shumë e mirë nëpër mure dhe tavane dhe me rezistencë të lartë mekanike. Të jetë cilësore. I ambalazhuar në paketim 1 ose >1 Kg sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
18	Insekticid për bletë/miza/milingona	Insekticid për ambiente të brendshme. Të jetë me aromë jo shumë të fortë. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

19	Kosh plastik për hedhe mbeturinash (5 litër)	Të jetë në formë drejtkëndore ose rrethore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum min 5 Litër.
20	Kosh ambienti metalik me kapak (5 litër)	Në forma të ndryshme, pjesa e sipërme e koshit të jetë me kapak që hapet me pedal ku të vihen qeset e koshit. Me volum min 5 Litër, material inox.
21	Kovë plastike me shtrydhje (10 litër)	Të jetë plastike, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jetë me volum min 10 Litër.
22	Letër duarsh me kuti (250 fije)	Me kuti, fletë palosje zig zag me përbërje 100% celuloze. Të jetë e paketuara në kuti ose në qese min 250 fije/pako. Letra të ketë mundësi thithje të lartë.
23	Leter higjenike (10 roll/pako)	Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, fletëpalosje zig-zagnë pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë
24	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	Me aromë natyrale, e përdorshme për higjienën min 100 fije/pako, për bebe dhe të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht, ti përshtatet pH të lëkurës.
25	Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95)	Me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, të uthiten lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojnë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 95\%$, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agjentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrave, ujit, etj. Të plotësojnë kërkesat e standardit europian EN 149: 2001 + A1: 2009 ose standardit amerikan NIOSH 95 ose ekuivalent. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

26	Maskë kirurgjikale e thjeshtë	Me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 99\%$, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, celuloze, poliestër, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë mbrojtje, me dimensione 90mm x 180mm (± 10 mm). Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.
27	Lecka për larje xhamash mikrofibër (32x32)	Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliestër dhe 20% poliamid
28	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	Të jenë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë me ambalazhim min 3 fije/pako.
29	Solucion për zhblllokim lavamani	Me efekt zhblllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës
30	Solucion për zhblllokim banjo 500 ml	Me efekt zhblllokimi të shpejtë. Ambalazhimi në shishe plastike në trajtë lëngu, ambalazhuar nga fabrika. Gjëndja fizike e lëngut të jetë homogjene, të ketë aromë të këndshme. Të mos ketë nevojë për tu holluar, në mënyrë që të mos krijojë spërkatje. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
31	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	Të jenë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë me ambalazhim min 3 fije/pako.
32	Qese mbeturinash 35 litër (10 fije/pako)	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
33	Qese mbeturinash 40 litër (10 fije /pako)	Qeset do të përdoren për mbetjet e rrezikshme mikrobiologjike dhe teshat e palara. Të jenë rezistente, me volum 40 litër. Të jetë material i biodegradueshëm.
34	Qese për mbeturina 60 litër (10 fije /pako)	Të jenë të paketuara në formë ruloje me min 15 fije dhe vëllim min 60 litër. Pakoja e pakeluar në formë ruloje. Të jetë produkt i biodegradueshëm dhe material i trashë.

35	Sapun i lëngshëm	Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 Faqe 14 nga 27 gr/cm ³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës
36	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik	Jo më pak se 70 cm të gjatë. Kacia të ketë gjerësi 21 cm, gjatësi 29 cm, thellësi 10 cm, +/- 2 cm marzh gabimi.
37	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me fshesë	Të jetë në formë kutie e hapur nga përpara për mbledhjen e papastërtive të ndryshme, e pajisur me një bisht të montueshëm dhe çmontueshëm. Të ketë edhe fshesë me bisht jo më të gjatë se 45 cm.
38	Sfungjer i thjeshtë	Të jenë të përdorshëm për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.
39	Sfungjer për pastrim hidrosanitarësh	Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjetë teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Anësoret të jenë me kanal për mbrojtjen e duarve.
40	Shkop për inoks për shtup	Jo më të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.
41	Shtupë për larje dyshemeje (mikrofiber)	I përbërë nga fibra tekstili me përbërje mikrofibrë që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastic nga jashtë.
42	Solucion larës dyshemeje (pllaka)	Me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ -1.1 gr/cm ³ .
43	Solucion larës EC dizinfektues (1liter)	Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të EC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri ne 1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.

44	Solucion larës xhamash	Me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.
45	Solucion për larjen e enëve xhel	Me efekt pastrimi të thellë të yndyrnave. Ambalazhimi në enë plastike me kapak. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e produktit të jetë xhel (në formë paste). Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6.5 deri në 8. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 20% deri në me 35%.
46	Solucion për pastrimin e smercit/kripave nga hidrosanitare me sprucim	Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitare. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
47	Solucion mizash dhe mushkonjash spray 500 ml	Spray me ambalazhim në paketim plastik. Të jetë me aromë jo shumë të fortë.
48	Fshesë për pastrim territori, melakuqi	Fshesa të jetë për pastrimin e territoreve të jashtme, e përbërë nga fije melakuqi të dendura dhe të kapura fortë me njëra tjetrën. Gjatësia e fijeve të fshesës të jetë mbi 40 cm. Shkopi fshesës të jetë me gjatësi mbi 1 metër.
49	Aparat për aromatizues ambienti me kohë sprucimi (për aromatizues 250 ml)	Aparat për ambient me kohë sprucimi me kapacitet për mbajtjen e solucionit. Të jetë i pajisur me bateri përkatëse.
50	Cizme gome të shkurtra numër 42/43	Me material gome cilësor, të ofrojnë mbrojtje ndaj ujit. Numrat çizmeve dhe ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

51	Sapun tualeti duarsh (75g)	Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm ³ . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm
52	Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12)	Ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor
53	Letër kuzhine e paketuar	Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje
54	Bluze mbrojtëse për pune aktive/Përparse (Masa M, L, XL)	Përparësja për sanitare duhet të jetë e përbërë nga material me përzierje 65% poliestër dhe 35% pambuk, duke siguruar rezistencë të lartë ndaj konsumit, ruajtje të formës dhe lehtësi në mirëmbajtje. Pambuku garanton komoditet dhe higjenë gjatë përdorimit, ndërsa poliesteri kontribuon në qëndrueshmëri dhe tharje të shpejtë. E përshtatshme për përdorim të përditshëm në ambiente pune me kërkesa higjienike dhe funksionale.
55	Aromatik tualeti (175g)	Me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e ËC-së.
56	Hipoklorit Kalciumi, përmbajtja e klorit aktiv 30%-40%	Pluhur i bardhë në gri e lehtë me erën karakteristike të klorit, i imët. Përmbajtja e klorit aktiv 30%-40%.

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia	Sasia
1	Acid për pastrim (liter)	copë	250
2	Xhel dezinfektues për duar (100ml)	copë	70
3	Aromatik tualeti (250ml) për aparat	copë	200
5	Cizme gome të gjata numer 42	copë	12

6	Cizme gome te gjata numer 43	copë	12
7	Doreza gome	copë	200
8	Doreza Latex ose Nitrile (Masa M /L)	copë	200
9	Enë plastike e vogël me një doreze (1 Litër)	copë	40
11	Fshesë me sfungjer dhe gome për pastimin e xhamave	copë	40
12	Fshesë merimangash me shkop	copë	25
13	Fshesë pastrimi pa bisht	copë	100
14	Fshesë pastrimi për ambjente të jashtme (industriale) me bisht	copë	100
15	Furca për lyerje muri me gëlqere	copë	40
16	Furca për pastrimin e ËC	copë	50
17	Gëlqere per lyerje (qese 10kg)	copë/pako	100
18	Insekticid për bletë/miza/milingona	litër	50
19	Kosh plastik për hedhje mbeturinash (5 litër)	copë	50
20	Kosh ambienti metalik me kapak (5 litër)	copë	70
21	Kovë plastike me shtrydhje (10 litër)	copë	80
22	Letër duarsh me kuti (250 fije)	copë	200
23	Letër higjenike (10 roll/pako)	copë/pako	350
24	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	copë/pako	50
25	Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95)	copë/pako	200
26	Maskë kirurgjikale e thjeshtë	pako	50
27	Lecka për larje xhamash microfibr (32x32)	copë/pako	150
28	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	copë/pako	150
29	Solucion për zhbllokim lavamani	copë	60
30	Solucion për zhbllokim banjo 500 ml	copë	60
31	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	copë	60
32	Qese mbeturinash 35 litër (10 fije/pako)	copë	1,000
33	Qese mbeturinash 40 litër (10 fije /pako)	copë/pako	1,000

34	Qese për mbeturina 60 litër (10 fije /pako)	copë/pako	1,000
35	Sapun i lëngshëm	copë/litër	200
36	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik	copë	60
37	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me fshesë	copë	70
38	Sfungjer i thjeshtë	copë/pako	65
39	Sfungjer për pastrim hidrosanitaresh	copë	100
40	Shkop për inoks për shtup	copë	200
41	Shtupë për larje dyshemeje (mikrofiber)	copë	100
42	Solucion larës dyshemeje (pllaka)	litër/copë	100
43	Solucion lares ËC dizinfektues (1liter)	copë	350
44	Solucion larës xhamash	copë	100
45	Solucion për larjen e enëve xhel	copë	15
46	Solucion për pastrimin e smercit/kriprave nga hidrosanitariet me sprucim	litër	100
47	Solucion mizash dhe mushkonjash spray 500 ml	copë	50
48	Fshesë për pastrim territori, melakuqi	copë	60
49	Aparat për aromatizues ambienti me kohë sprucimi (për aromatizues 250 ml)	copë	60
50	Cizme gome të shkurtra numër 42/43	copë	24
51	Sapun tualeti duarsh (75g)	copë	100
52	Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12)	litër/kg	120
53	Letër kuzhine e paketuar	rulo	60
54	Bluzë mbrojtëse për pune aktive/Përparse (Masa M, L, XL)	copë	35
55	Aromatik tualeti (175g)	copë	60
56	Hipoklorit Kalciumi, përmbajtja e klorit aktiv 30%-40%	kg	70

Afatet e lëvrimit:

7 (shtatë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. Ky afat është vlerësuar si i mjaftueshëm për realizimin e kontratës me sukses nga operatori ekonomik i suksesshëm.

Emërtimi i produkteve, specifikimet teknike, njësitë janë hartuar nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve bazuar në Katalogun e Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara “Për blerje materialesh të ndryshme për pastrim” datë 11.12.2024 dhe katalogun “Për blerje materialesh të buta dhe veshmbathje” datë 22.04.2025.

Fondi limit i kësaj procedure prokurimi është përllogaritur nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve bazuar në nenin 76 të Kreut X të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe Kataloget e Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara “Për blerje materialesh të ndryshme për pastrim” datë 11.12.2024 dhe “Për blerje materialesh të buta dhe veshmbathje” datë 22.04.2025.

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

NJËSIA E PROKURIMIT